

RELACION

PËR

DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10416, DATË 7.4.2011, “PËR MATERIALIN MBJELLËS E SHUMËZUES BIMOR”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është ndryshimi i disa neneve të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës e shumëzues bimor”, të ndryshuar, dhe riformulimi i nenit 44, i këtij ligji, për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, ku janë analizuar të gjitha licencat dhe lejet e përfshira në anekset 1 dhe 2, të vendimit nr.538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

Ky projektligj është hartuar pas konsultave me grupet e interes, kryesisht, Entin Shtetëror të Farave e Fidanave, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore, si dhe subjekteve, “Agroblend”, “Arlu internacionale”, Agrohelf” dhe “Agroinput-Jazxhi”. Gjithashtu, në kuadër të reformës së deregullimit, në përfundim të analizës, ndër të tjera arrihet në konkluzionin se eliminohen 23 licenca.

Me anë të këtyre ndryshimeve synohet të arrihet:

- a) reduktim i barrierave administrative;
- b) liberalizim i tregut;
- c) përmirësim i mëtejshëm i klimës së biznesit;
- ç) përcaktimi i rregullave dhe procedurës së marrjes së mostrave, përgatitjes dhe dërgimit të këtyre mostrave për analizë në laboratorin qendror të farave apo laboratorët rajonalë
- d) përcaktimi i rregullave dhe kriterëve, që duhet të plotësojë laboratorit i referencës dhe laboratorët e autorizuar.

Në praktikën e kryerjes së analizave të materialit mbjellës e shumëzues bimor, veçanarisht pas miratimit të ligjit nr.105/2015, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës e shumëzues bimor”, të ndryshuar, inspektorët e AKU-së kanë hasur vështirësi lidhur me procedurën e marrjes së mostrave, përgatitjes dhe dërgimit të këtyre mostrave për analizë në

laboratorin qendror të farave apo laboratorët rajonalë.

Nga ana tjetër, edhe specialistët e laboratorëve, pas miratimit të ligjeve të sipërcituara, (Ligji nr.10416 datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar, dhe ligji nr.105/2015, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.10416, “Për materialin mbjellës e shumëzues bimor”, të ndryshuar), nuk kanë të përcaktuar metodikën e pranimit të mostrave, rrugën që ndiqet deri në kryerjen e analizave dhe njoftimin e subjektit për rezultatet e tyre. Për këtë arsye, bazuar edhe në sugjerimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me shkresën nr.4082 prot, datë 14.6.2016, “Jepet mendim për një projektvendim” për të mos hartuar VKM sipas kërkesave të pikës 4, të nenit 44, të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës e shumëzues bimor”, të ndryshuar, por të ndryshojë dhe të riformulohet i gjithë neni 44 me arsyetimin se kriteret që duhet të plotësojë laborator i akredituar nuk mund të përcaktohen me VKM, siç është e përcaktuar në pikën 4, të nenit 44, të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar, por përcaktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit apo institucion tjetër i pavarur. Për këtë qëllim, u zhvilluan konsulta të veçanta me inspektorët e AKU-së dhe specialistët e sektorit të certifikimit duke marrë edhe mendimin e tyre për riformulimin e nenit 44.

Mendimet dhe sugjerimet e AKU-së dhe ESHFF-së janë reflektuar në draftin e paraqitur, mbi bazën e të cilit është formuluar edhe neni 8 i projektligjit. Projektligji përcakton rregulla më të qarta për analizat e materialit mbjellës e shumëzues bimor, kriteret që duhet të plotësojë laborator për t’u konsideruar laborator reference dhe i miratuar dhe llojet e analizave që kryejnë këta laboratorë.

Gjithashtu, në këtë projektligj përcaktohen rregulla më të qarta për analizat laboratorike të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, mënyrën e miratimit të laboratorit të referencës, besueshmërinë e analizave të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në laboratorët e miratuar dhe rolin e laboratorit të referencës për efekt verifikimi të saktësisë dhe besueshmërisë së analizave të materialit mbjellës e shumëzues bimor.

Ndryshimi dhe riformulimi i nenit 44 synon të arrijë këto objektiva:

- Kryerjen e analizave laboratorike zyrtare të materialit mbjellës e shumëzues bimor në laboratorë të miratuar dhe atë të referencës në përputhje me standardet bashkëkohore;
- Miratimin e laboratorit të referencës si laborator që vlerëson cilësinë dhe besueshmërinë e analizave të materialit mbjellës e shumëzues bimor nga laboratorët e miratuar;

- Përcaktimin e procedurave që ndiqen për marrjen e mostrave, lëvizjen e tyre, kryerjen e analizave dhe njoftimin e subjekteve për rezultatet e tyre;
- Akreditimin e laboratorit të referencës brenda dy viteve nga një institucion i pavarur.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ndryshimi dhe riformulimi i nenit 44 të këtij projektligji nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është bazuar edhe në sugjerimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me shkresën nr.4082 prot, datë 14.6.2016, “Jepet mendim për një projektvendim” për të mos hartuar VKM sipas kërkesave të pikës 4, të nenit 44, të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës e shumëzues bimor”, të ndryshuar, por të ndryshojë dhe të riformulohet i gjithë neni 44 me arsyetimin se kriteret që duhet të plotësojë laborator i akredituar nuk mund të përcaktohen me VKM, siç është e përcaktuar në ligjin e sipërpërmendur, por përcaktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Po kështu, ESHFF-ja, AKU-ja, agrobiznesi bujqësor, importuesit dhe prodhuesit e materialit mbjellës e shumëzues bimor kanë pasur gjithmonë kërkesa për të ndryshuar përcaktimet e pikave 1 dhe 4, të nenit 44, me arsyetimin se përcaktimi i pikës 1 të nenit 44, analizat laboratorike zyrtare të materialit mbjellës e shumëzues bimor kryhen në laboratorë të akredituar të miratuar për këtë qëllim gjë që bie në kundërshtim me praktikën e deritanishme të kryerjes së analizave në laboratorin qendror të ESHFF-së dhe laboratorë të tjerë të strukturave të varësisë të ministrisë së bujqësisë.

Ky projektligj është parashikuar në programin analitik të akteve që do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave në vitin 2018, si dhe është në përputhje me reformën e deregullimit.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Neni 5, i ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se *“Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, si rregull, kushtet e përgjithshme të licencimit, autorizimit dhe lejimit, organi kompetent që vlerëson përmbushjen e këtyre kushteve, organi kompetent për inspektimin dhe/ose për revokimin e licencës, autorizimit dhe lejes, si dhe shkaqet e revokimit përcaktohen me ligj,*

ndërsa kushtet e posaçme të licencimit, të autorizimit dhe lejimit, dokumentet shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë, autorizim apo leje, afati i vlefshmërisë së licencës, të autorizimit dhe lejes, procedurat e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e revokimit miratohen me akt nënligjor, në bazë dhe në zbatim të këtij ligji dhe të ligjit që e parashikon atë licencë, autorizim apo leje”.

Për sa më sipër, me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencës “Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe fidanëve”, me kodin II.4. Me shfuqizimin e kësaj licence ushtrimi i veprimtarisë së prodhimit dhe/ose tregtimit të farave dhe fidanëve do të jetë i lirë.

Shfuqizimi i licencës dhe lehtësimi i operatorëve nga kjo barrë nuk përjashton dhe nuk pengon punën e inspektoratit të AKU-së për të kontrolluar përmbushjen e kushteve që duhet të plotësojnë subjektet për përshtatshmërinë e ambienteve dhe mjediseve për përpunimin, paketimin, ruajtjen dhe tregtimin e farave për të siguruar temperaturën dhe lagështirën optimale për ruajtjen e treguesve cilësorë dhe parametrave teknikë për farat të cilat janë të parashikuar në VKM-të e miratuara sipas pikës 9, të nenit 4, të ligjit nr.10416/2011.

Gjithashtu, projektligji parashikon se prodhimi i kategorive të larta të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor bëhet nga furnizues publikë të autorizuar ose privatë të regjistruar në regjistrin tregtar (QKB).

Me ndryshimin dhe riformulimin e nenit 44, të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimi Rural synon të bëjë disa përmirësime të nevojshme në fushën e analizimit të materialit mbjellës e shumëzues bimor në laboratorët e miratuar dhe atë të referencës për të vendosur në treg material mbjellës e shumëzues bimor me cilësinë e kërkuar.

Ndryshimi dhe riformulimi i këtij neni përcakton se laborator i referencës miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë, si dhe shërben si laborator i vlerësimit të cilësisë dhe besueshmërisë të analizave të kryera në laboratorë të tjerë.

Me këto ndryshime i sigurohet biznesit të kësaj fushe, që importon material mbjellës e shumëzues bimor nga vendet e BE-së apo vendet që kanë nënshkruar marrëveshjen me UPOV-in, kryerjen e analizave të besueshme dhe me cilësi, si dhe i siguron fermerët se materiali mbjellës e shumëzues bimor që vendoset në treg dhe që përdoret nga ato për mbjelljen e bimëve bujqësore është i cilësisë së kërkuar dhe se analizat e kryera janë të besueshme.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është përgatitur në mbështetje neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji nga Kuvendi krijon besueshmërinë e analizave laboratorike të materialit mbjellës e shumëzues bimor që vendoset në treg, siguron fermerët se materiali mbjellës e shumëzues bimor i analizuar në laboratorët e autorizuar dhe laboratorin e referencës është në cilësinë e kërkuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Nuk ka përafrim me acquis e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban 11 nene:

Në nenin 1 jepet ndryshimi i nenit 3 të ligjit në fuqi, duke shtuar përkufizimet për laboratorin e akredituar, si dhe riformulim të përkufizimit për laboratorët e referencës. Në këtë pikë përcaktohet se laborator i referencës është laborator i cili shërben si laborator për vlerësimin zyrtar të cilësisë e të besueshmërisë së analizave të kryera në laboratorët e autorizuar, jep vlerësimin përfundimtar të testeve të kryera në këta laboratorë, si dhe përcaktohet se laboratorët e akredituar janë laboratorët që kanë kaluar një procedurë akreditimi për të kryer analizat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e akreditimit, si dhe laboratorin e autorizuar.

Nenet 2 deri 7 janë propozime të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pas analizës së kyer në kuadër të reformës së derregullimit.

Në këto nene propozohet shfuqizimi i licencës “Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe fidanëve” me kodin II.4. Me shfuqizimin e kësaj licence ushtrimi i veprimtarisë së prodhimit dhe/ose tregtimit të farave dhe fidanëve do të jetë i lirë. Ndërkohë, ky projektligj parashikon se prodhimi i kategorive të larta të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor bëhet nga furnizues publikë ose privatë që ushtrojnë këto veprimtari dhe kanë detyrimin të regjistrojnë në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, prodhimin e kategorive të larta të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

Në nenin 8 jepet riformulimi i nenit 44, të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, konkretisht:

Në pikën 1 përcaktohet se analizat laboratorike, zyrtare të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor kryhen në laboratorë të autorizuar dhe laborator reference të miratuar nga ministri përgjegjës për bujqësinë si të tillë dhe se këta laboratorë miratohen me urdhër të ministrit vetëm nëse plotësojnë kushtin që të jenë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi për akreditimin. Gjithashtu, lista e analizave të miratuara për këta laboratorë duhet të jetë e përfshirë në listën e analizave për të cilat laboratori është i akredituar.

Në pikën 2 përcaktohet se laboratori i referencës kryen analizat e mostrave, që merren për efekt verifikimi dhe vlerësimi të treguesve cilësorë për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

Në pikën 3 përcaktohet se laboratori i referencës dhe laboratori i autorizuar akreditohet nga një organizëm kombëtar i akreditimit. Aktualisht këtë funksion sipas legjislacionit në fuqi e kryen Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Në pikën 4 përcaktohet se kriteret, që duhet të plotësojë laboratori i references, miratohen me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

Në pikën 5 përcaktohet se procedura që ndiqet për marrjen e mostrave dhe lëvizja e tyre për kryerjen e analizave në laborator, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Në pikën 6 përcaktohet se lista e analizave që kryen laboratori i referencës botohet në “Fletoren zyrtare”.

Në nenin 9 jepet riformulimi i pikës 7, të nenit 54, duke zëvendësuar lidhësen “e” me “ose”, për t’i dhënë kuptim më të saktë përcaktimit të dhënë në këtë pikë.

Neni 10 përcakton ndryshimet e pikave 1 dhe 2, të nenit 58, të ligjit në fuqi, ku përcaktohet nxjerrja e akteve të nevojshme nënligjore, kjo në funksion të ndryshimeve të propozuara në këtë projektligj.

Neni 11 përcakton se ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Enti Shtetëror i Farave e Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE